

VENDIM
Nr.847, datë 17.12.2004

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REHABILITIMI I SHKARJEVE
NË BARMASH, NË SEGMENTIN RRUGOR ERSEKË -LESKOVIK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik" dhe të nenit 7 të ligjit nr.9165, datë 23.12.2003 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2004", me propozimin e Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit, Këshilli Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga rehabilitimi i shkarjeve në Barmash, në segmentin rrugor Ersekë - Leskovik.
2. Shpronësimi të bëhet në favor të Ministrisë së Transportit dhe të Telekomunikacionit.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqiten në tabelën që bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqe 1300 m² tokë arë, me çmim 500 lekë/m², dru frutorë (qersh) 4 copë, me çmim 1 556 lekë/për rrënjë, me vlerë të përgjithshme 656 224 (gjashtëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e njëzet e katër) lekë.
4. Vlera e shpenzimeve procedurale të jetë në shumën 108 500 (njëqind e tetë mijë e pesëqind) lekë.
5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 764 724 (shtatëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e njëzet e katër) lekësh të përballohet nga Buxheti i Shtetit i vitit 2004, zëri "Shpronësime", miratuar për Ministrinë e Transportit dhe të Telekomunikacionit.
6. Shpronësimi të përfundojë brenda datës 30.12.2004.
7. Ngarkohet Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE E TELEKOMUNIKACIONIT
DREJTORIA JURIDIKE
QARKU KORÇË
Rrethi Ersekë
Komuna Barmash

**LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË REHABILITIMIT TË
SHKARJEVE NË BARMASH, TË SEGMENTIT RRUGOR ERSEKË-LESKOVIK**

Lloji i pasurisë së paluajtshme: tokë bujqësore

Nr.	Pronari			Fshati Z.K.	Nr.i pasurisë	Tokë bujq. sip.m ²	Çmimi lek/m ²	Vlera në lekë	Dru frutore copë	Çmimi lekë/copë	Vlera në lekë	Totali lekë	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri										
1	Hajro	Rrushan	Muhameti	1119	36/1	1300	500	650000	4	1556	6224	656224	Mungon kartela
		Shuma				1300		650000				656224	

Shpenzime procedurale: 108 500 lekë.

Vlera totale e shpronësimit: 764 724 lekë.